

Në bazë të Nenit 62, dhe në lidhje me Nenin 7 të Ligjit për Kulturë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 31/98, 49/03, 82/05, 24/07, 116/10, 47/11, 51/11, 136/12, 23/13, 187/13, 44/14, 61/15, 154/15, 39/16, 11/18 dhe 11/18) Qyteti i Shkupit shpall

THIRRJE PUBLIKE

për grumbullimin e kërkesave për shfrytëzimin e mjeteve nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2025, të dedikuara për financimin dhe përkrahjen e programeve dhe projekteve të institucioneve publike nga fusha e kulturës të themeluara nga Qyteti i Shkupit për vitin 2025

I

Qyteti i Shkupit do të marrë pjesë në financimin dhe përkrahjen e programeve dhe projekteve të institucioneve publike nga fusha e kulturës të themeluara nga Qyteti i Shkupit në fushat vijuese:

- 1.1. Arte performuese
- 1.2. Arte muzikore
- 1.3. Arte vizuale dhe arte të medimeve të reja
- 1.4. Veprimtari botuese dhe bibliotekare
- 1.5. Veprimtari muzeore dhe promovimi i trashëgimisë kulturore
- 1.6. Bashkëpunim ndërkombëtar

II

Institucionet publike nga fusha e kulturës të themeluara nga Qyteti i Shkupit për pjesëmarrje në Thirrjen publike duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- ruajtja dhe afirmimi i trashëgimisë materiale, shpirtërore dhe kulturore të qytetit të Shkupit;
- nxitja dhe afirmimi i shumëllojshmërisë dhe larmisë etnike në kulturë;
- inovacion, përshtypje dhe origjinaliteti i idesë;
- vazhdimësia e manifestimeve tradicionale kulturore – artistike, që janë me interes për qytetin e Shkupit;
- promovimi i trashëgimisë kulturore të qytetit të Shkupit;
- prezantimi dhe afirmimi i krijimtarisë bashkëkohore, kulturës urbane dhe artit publik;
- kujdesi për infrastrukturën publike në suaza të kulturës dhe stimulimi i medimeve të reja dhe hulumtimeve në fushën e kulturës;
- stimulimi dhe përkrahja e projekteve të ndryshme partneriteti ndërkombëtare;
- përkrahja dhe zhvillimi i vlerave tradicionale kulturore;
- themelimi i bashkëpunimit në suaza të projektit të propozuar me një ose më shumë institucione kulturore dhe organizata;
- organizimi i festivaleve ndërkombëtare që mbahen në Shkup;
- kremtimi i evenimenteve jubilarë dhe datave me rëndësi në kulturë;
- publikim i librave dhe botimeve elektronike, monografive, përmbledhjeve që trajtojnë tema nga jeta dhe historia e Shkupit;
- projekte qëllimi i të cilave është zhvillimi dhe promovimi i fushave të kulturës dhe industrive kreative;

- realizimi i filmave dokumentarë që kanë të bëjnë me historinë dhe jetën bashkëkohore në qytetin e Shkupit;
- nxitje e mendimit shkencor dhe kritik përmes organizimit të seminareve, konferencave, debateve të cilat trajtojnë tema nga jeta dhe historia e Shkupit;
- bashkëpunim dhe pjesëmarrje në manifestimet, festivale dhe në projekte ndërkombëtare në bazë të reciprocitetit,
- programe dhe projekte nga fusha e kulturës që zhvillohen në territorin e qytetit të Shkupit dhe të cilat kanë siguruar mjete financiare (grante) nga fondet e Komisionit Evropian, UNESCO ose organizata të tjera ndërkombëtare;
- bashkëpunim dhe projekte me organizata, institucione dhe individë nga qytetet e vëllazëruara me Qytetin e Shkupit

III

Qëllime të veçanta për fushat e përcaktuara në thirrjen publike:

1) Qëllime të veçanta në fushën e veprimtarisë muzeore dhe promovimit të trashëgimisë kulturore:

- prezantimi, popullarizimi dhe promovimi i trashëgimisë kulturore dhe historike në qytetin e Shkupit;
- përdorimi i trashëgimisë kulturore si burim për zhvillimin e turizmit;
- organizimi i fushatave, punëtorive dhe ligjëratave për promovimin dhe rëndësinë e trashëgimisë kulturore në territorin e qytetit të Shkupit.

2) Qëllime të veçanta në fushën e veprimtarisë botuese dhe bibliotekare:

- botimi i librave dhe edicioneve elektronike, botimeve, monografive, antologjive që trajtojnë tema të jetës bashkëkohore dhe të historisë së Shkupit;
- mbështetje e krijimtarisë letrare me vlera të larta nga autorë që krijojnë në gjuhën maqedonase dhe në gjuhët e komuniteteve në qytetin e Shkupit;
- vepra me vlera të jashtëzakonshme kulturore, monografi, botime profesionale, si dhe vepra që janë rezultat i projekteve hulumtuese për qytetin e Shkupit;
- botime të dedikuara për fëmijët dhe të rinjtë;
- për vepra të autorëve me botim të parë janë të detyrueshme dy (2) recensione dhe për vepra të autorëve me disa vepra letrare të botuara është i detyrueshëm një (1) recension

3) Qëllime të veçanta në fushën e arteve vizuale dhe artit të medimeve të reja:

- ekspozita monografike-retrospektive me rëndësi të veçantë për qytetin e Shkupit që pasqyrojnë vazhdimësinë e veprimtarisë artistike në Shkup të konfirmuara nga kritika e artit dhe historia e artit;
- projekte të pavarura, grupe dhe të tjera nga vendi dhe jashtë vendit që promovojnë format dhe shprehjet artistike bashkëkohore dhe kontribuojnë në zhvillimin e gjuhës artistike bashkëkohore në qytetin e Shkupit;
- promovimi dhe zhvillimi i artit bashkëkohor urban me theks në shfrytëzimin e hapësirave publike të qytetit si dhe hapësirave të tjera alternative për prezantimin e veprave të artit në qytetin e Shkupit;
- mbështetja e festivaleve të filmit;

- projekte ekspozite në fushën e industrive krijuese; dhe
- ekspozita dhe projekte të artistëve të rinj në fushën e arteve vizuale dhe artit të medieve të reja (deri në 35 vjeç).

4) Qëllime të veçanta në fushën e artit skenik:

- kultivimi dhe prezantimi i krijimtarisë kombëtare dramatike dhe muzikore-skenike të stileve dhe zhanreve të ndryshme artistike me përfaqësimin e autorëve tradicionalë dhe bashkëkohorë;
- prezantimi i veprave më të mira artistike nga dramaturgjia botërore në Shkup, si dhe veprave nga fusha e artit muzikor dhe skenik,
- punëtori me të rinjtë si dhe me persona me nevoja të veçanta në fushën e arteve dramatike dhe muzikore-skenike;
- mbështetja e festivaleve teatrore;
- prezantimi i folklorit maqedonas dhe i folklorit të pjesëtarëve të komuniteteve që jetojnë në qytetin e Shkupit; dhe
- prezantimi i folklorit maqedonas dhe i folklorit të pjesëtarëve të komuniteteve që jetojnë në qytetin e Shkupit në festivale dhe manifestime që mbahen në qytete të vendeve të tjera me të cilat qyteti i Shkupit ka bashkëpunim, gjë për të cilat duhet të depozitohet ftesë nga organizatori i manifestimit.

5) Qëllime të veçanta në fushën e arteve muzikore:

- promovimi dhe interpretimi i veprave dhe krijimtarisë muzikore me shumëllojshmëri stilistike dhe zhanresh;
- nxitja dhe interpretimi i formave dhe shprehjeve të reja muzikore;
- mbështetja e festivaleve muzikore,
- stimulimi i krijimtarisë muzikore maqedonase dhe krijimtarisë muzikore të komuniteteve që jetojnë në qytetin e Shkupit me vlera të larta artistike; dhe
- mbështetje për koncertet e muzikantëve të rinj - interpretues dhe kompozitorë.

6) Qëllimet e veçanta në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar:

- bashkëpunimi dhe pjesëmarrja në manifestime ndërkombëtare, festivale dhe projekte të bazuara në reciprocitet, për të cilat duhet të depozitohet ftesë nga organizatori;
- programe dhe projekte në fushën e kulturës që do të zhvillohen në territorin e qytetit të Shkupit dhe të cilat kanë siguruar mbështetje financiare (grant) nga fondet e Komisionit Evropian, UNESCO-s dhe/ose fondeve të tjera ndërkombëtare; dhe
- bashkëpunimi dhe zbatimi i projekteve të përbashkëta me organizata, institucione dhe individë nga:
 - a) qytete të binjakëzuara me Qytetin e Shkupit
 - b) qytete me të cilat është vendosur protokoll ose program bashkëpunimi dhe
 - c) qytete që bashkëpunojnë me Qytetin e Shkupit në bazë të kontakteve të vendosura (<https://skopje.gov.mk/>) – link i portalit zyrtar të Qytetit të Shkupit.

IV

Përzgjedhja e programeve dhe projekteve do të kryhet mbi bazën e kriterëve të shprehura në pikë si më poshtë:

Kritere	pikë
1. Cilësia e programit/projektit:	50
1.1 Aktivitete programore të përgatitura në mënyrë të hollësishme nga programi/projekti dhe aplikim i plotësuar në përputhje me Thirrjen publike.	20
1.2 Kontributi i programit/projektit në realizimin e qëllimeve të përgjithshme dhe të veçanta për zhvillimin e kulturës në nivel të Qytetit të Shkupit	10
1.3 Zgjidhje cilësore dhe inovative të ofruara për realizimin e qëllimeve projektuese të cilat përmbajnë inovacione, mbresa dhe origjinalitet të ideve.	10
1.4 Dukshmëria e organizatës – (online)	10
2. Buxheti i projektit:	50
2.1 Plan i hollësishëm financiar i përgatitur për mjetet e nevojshme për realizimin e programit-projektit	30
2.2 Mjete shtesë të siguruara nga burime vetjake ose të tjera.	20
Pikë gjithsej:	100

V

Mjetet e dedikuara për financimin e programeve dhe projekteve të institucioneve kulturore, do të parashikohen me Buxhetin e Qytetit të Shkupit për vitin 2025.

Pas miratimit të Buxhetit të Qytetit të Shkupit për vitin 2025 dhe në varësi nga mjetet në dispozicion dhe nevojat e Qytetit, kryetari i Qytetit të Shkupit do të sjellë Aktvendim për financimin e projekteve.

Pagesa e mjeteve do të bëhet në bazë të planit financiar të miratuar nga Sektori për Çështje Financiare i Qytetit të Shkupit.

Qyteti i Shkupit do të lidhë marrëveshje me secilin institucion me qëllim rregullimin më nga afër të të drejtave dhe detyrimeve.

VI

Aplikimi për Thirrjen publike realizohet me depozitimin e fletëparaqitjes (aplikimit) së plotësuar në arkivin e Qytetit të Shkupit (baraka 16).

Fletëparaqitjet (aplikimet) mund të shkarkohen nga ueb-faqja zyrtare e Qytetit të Shkupit <https://skopje.gov.mk/mk/apliciraj/javni-povici/>.

VII

Thirrja publike zgjat 30 ditë kalendarike nga dita e shpalljes në ueb-faqen zyrtare të Qytetit të Shkupit www.skopje.gov.mk.

Aplikimet, në formë të shkruar dhe në formë elektronike në formatin WORD, duhet të depozitohen në Qytetin e Shkupit, nëpërmjet postës në adresën: Bul. "Ilinden" nr.82, 1000 Shkup, ose në arkivin e Qytetit të Shkupit, me shënimin:

„Thirrje publike për grumbullimin e kërkesave për shfrytëzimin e mjeteve nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2025, të dedikuara për financimin dhe përkrahjen e programeve dhe projekteve të institucioneve publike nga fusha e kulturës të themeluara nga Qyteti i Shkupit për vitin 2025“.

Qyteti do të lidhë marrëveshje me institucionet, fletëparaqitjet (aplikimet) e të cilave do të pranohen, në varësi nga mjetet në dispozicion në Buxhetin e Qytetit të Shkupit për vitin 2025 dhe nga nevoja e Qytetit për realizimin e të njëjtave, dhe në përputhje me Programin për financimin e institucioneve publike dhe aktiviteteve nga fusha e kulturës në interes për Qytetin e Shkupit për vitin 2025 do të përcaktohen programet dhe projektet e institucioneve publike për të cilat janë miratuar mjete financiare nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për 2025.

Rezultatet e Thirrjes publike, do të shpallen në ueb-faqen zyrtare të Qytetit të Shkupit www.skopje.gov.mk.

Informacione plotësuese mund të merren në telefonat: 02/3297-324, 02/3297- 289 dhe adresën e-mail kultura@skopje.gov.mk.

Qyteti i Shkupit